



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, si dhe Rregullore Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil , Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM I BRENDSHËM

Institucioni:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
Koeficienti / 10

Nr. i Referencës: MTI/ 10

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1

Vendi: Prishtinë

Datë: 12.07.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë departamentin dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë dhe objektivat e ministrisë dhe harton plane të punës vjetore të detajuara për të përmbushur këto objektiva;
- Menaxhon stafin dhe buxhetin e departamentit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit ;
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistikën e institucionit dhe teknologjinë informative;
- Menaxhon dhe mirëmban informata për burimet njerëzore, shpenzimin e buxhetit , shërbimet e logjistikës dhe transportit;
- Ndihmon njësitë organizative të institucionit në planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit dhe shpenzimit të tij sipas procedurave ligjore;
- Ofron ndihmë dhe siguron mbështetje logjistike dhe administrative departamenteve të tjera funksionale, si dhe siguron rrjedhën e informatave të duhura dhe koordinimin e çështjeve administrative;

- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Ekonomik, Juridik, Administrim Biznesi ,Administratë Publike;
- Minimum 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirës së paku 4 vite në pozitë drejtuese;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e shërbimeve të përbashkëta ,buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

19.07.2019.

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **19.07.2019**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e pakompletuara si dhe kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.